



Nga Presidenti Dallin H. Oaks,
Këshilltar i Parë në
Presidencën e Parë

Pendimi Sjell Gëzim!

Pendimi është gëzim. Është pjesë e rëndësishme e planit të Perëndisë. Ne të gjithë kemi nevojë të pendohe mi.

Për t’u pënuar, ne duhet ta fillojmë me besim te Jezu Krishti. Duhet t’i braktisim mëkatet dhe t’i rrëfejme ato. Kjo do të thotë që ne e kuptojmë se vepruam gabim, që u kërkujmë falje atyre që i lëndojmë, dhe zgjedhim të bëjmë zgjedhje më të mira. Gjithashtu duhet të marrim sakramentin çdo ditë Shabati.

Kur pendohe mi, ne do të jemi të pastër. Zoti premt on se Ai “nuk [do t’i] kujtoj[ë] më [mëkatet tona]” (Doktrina e Besëlidhje 58:42). Çfarë premtimi! Çfarë mrekullie! Çfarë bekimi!

Shpëtimtari ynë i dashur i hap krahët e Tij për t’i pranuar të gjithë ata që pendohe n dhe e ndjekin Atë. ●

I përshtatur nga biseda “Të Pastruar nëpërmjet Pendimit”, Liahona, maj 2019, f. 91–94.

Të Pastër Përsëri

Bëje këtë veprimtari që të të ndihmojë të mësosh rreth pendimit.

Materialet që të nevojiten:



1. Mbush një enë të pastër me ujë. Më pas hidh disa gurë e ca dhë në ujë. Kjo përfaqëson zgjedhjet e gabuara që bëjmë.



2. Për t’u bërë të pastër përsëri, nevojitet që të mos e bëjmë më atë që është e gabuar. Për ta përfaqësuar këtë gjë, nxirri gurët nga ena. Si duket uji tani? A është ende i papastër?



3. Për t’u pënuar plotësisht, kemi nevojë për Jezu Krishtin. Kemi nevojë që të kemi besim tek Ai dhe te Shlyerja e Tij. Mbaje enën e ujit poshtë një rubineti. Lëre ujin e pastër të bjerë në enë derisa i gjithë uji i papastër të dalë jashtë. Kjo përfaqëson fuqinë që ka Jezu Krishti për të na ndihmuar që të bëhemi të pastër.

